



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 19, Datë 19.01.2018

MBI

**ÇMIMIN VJETOR TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË DO T'U
PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI TË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR VITIN 2018.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 22 të Ligjit nr.7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 22.11.2017 “Metodologjia e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, si dhe nenit 19 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 19.01.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve në lidhje me miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2018,

Konstatoi se:

- Metodologjia e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për llogaritjen e këtij çmimi parashikon :
 - Çmimi vjetor i blerjes (lekë/kWh) = Çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) i energjisë elektrike në profiling bandë (baseload) i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent/kWh X bonusin për promovimin e burimeve të rinovueshme në masën 1.3 X normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit.
- Nga të dhënat e raportit vjetor të Bursës së Energjisë së Hungarisë (HUPX) rezultojnë se çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profiling bandë (baseload) për vitin 2017 është në vlerën 50.35 Euro/MWh.
- Nga të dhënat e publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit Lekë/EUR, për çdo muaj të vitit 2017 kursi mesatar i këmbimit për vitin 2017 rezultojnë 134.15 Lekë/EUR. Në rast se kursi i këmbimit Lekë/Euro që do të publikohet në Raportin Vjetor

2017 të Bankës së Shqipërisë ndryshon nga çmimi mesatar i llogaritur, ERE rezervon të drejtën që të rishikojë llogaritjet në zbatim të metodologjisë.

- Në zbatim të formulës përlllogaritëse të pikës 3 të nr. 687, datë 22.11.2017 “Metodologjia e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, rezulton si më poshtë :

$$\triangleright P_u=50.35/1000*1.3*134.15=8.78078825 \text{ Lekë /kWh}$$

- Paragrafët 2.ç dhe 2.d të VKM nr. 687, datë 22.11.2017 “Metodologjia e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, parashikojnë që, çmimi I blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi të cilët mund të jetë jo më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 dhe jo më i lartë se 15% e çmimit të miratuar nga ERE për vitin 2016.
- Bordi i ERE-s, me Vendimin nr. 13 datë 16.02.2016 ka vendosur që, Tarifa fikse e energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2016, do të jetë 7.448 lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2018, do të jetë 8.5652 Lekë/kWh.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

Votimi i Antarëve të Bordit të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 19, Datë 19.01.2018

MBI

ÇMIMIN VJETOR TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË DO T'U
PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI TË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR VITIN 2018.

An tar t e Bordit

	Pro	Kund r
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Erjola Sadushi	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____